


	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorin Ekonomik: N.SH. "GEO – MININGU" me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi – U.d. Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.06.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 21.06.2019, të parashtruar nga Operatorin Ekonomik: N.SH. "GEO – MININGU" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS**, me Numër të prokurimit: **623-19-2463-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-020-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatorin Ekonomik: N.SH. "GEO – MININGU" me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS**, me Numër të prokurimit: **623-19-2463-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-020-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 19.06.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autortieti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS**, me Numër të prokurimit: **623-19-2463-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-020-2-2-1**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatorin Ekonomik: **N.SH. "GEO – MININGU"** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS**, me Numër të prokurimit: **623-19-2463-2-2-1**, Nr i brendshëm: **623-19-020-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 19.06.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 21.06.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Pretendimi 1:

1. *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shitesë Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.*

Përgjigje nga AK 1: Sipas paragrafit 2 të nenit 51 të LPP – së, në asnjë rast Njoftimi per Kontratë dhe Dosja e Tenderit nuk do të kërkojnë nga O.E. që të dorëzojë dokumentet ose informata që nuk kërkojnë ose nuk janë në përputhshmëri me nenet 65–70 të këtij ligji.

Po ashtu bazuar ne nenin 69 të LPP – së, paragrafi 1 specifikohen referencat se cilat mund të kerkohen per te deshmuar qarkullimin e O.E. nga se parafi 2 po i këtij neni thotë që A.K. do të specifikoi ne Njoftim dhe Dosjen e tenderit se cilen nga referencat mund ti kerkoj sipas paragrafit 1 neni 68 të LPP – së.

Operatori Ekonomik po kërkonë që të plotësoj tenderin me dokumenta që nuk lejohen sipas nenit 69.

Neni 72 paragrafi 3 i LPP – së informacioni plotsuese per dokumentet ekzistenca e te cilave eshte fiksuara, para skadimit te afatit per dorzim te ofertave.

Ne nuk kemi mund ti kerkojm nga Operatori Ekomomik: • Licenca përkatëse – Kopje të noterizuara, sepse nuk kanë qenë as kopje të noterizuara, dhe rrjedhimisht dokumentet e tilla të noterizuara pas datës së hapjes: 30.04.2019, janë të papranueshme per AK sespe janë në kundërshtim me LPP.

Sipas kesaj qe u tha me lart AK ka te drejt te merr per baze vetem ate qe ka kerkuar ne DT, AK ka te drejt te cakoj cilen referenc do ta kerkoi dhe po ashtu nuk guxon te pranoj si valid asnje dokument pas afatit te tenderimit.

Pretendimi 2:

2. *AK ka dëmtuar buxhetin e komunës për 23% duke eliminuar ofertën tonë në krahasim me ofertën fituese, apo për 3,334.00 Euro.*

Përgjigje nga AK 2: Autoriteti Kontraktues ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Gjatë Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahasimit të Tenderëve, **Operatorit Ekonomik: "ECO – ILIRIA" Sh.p.k.** me adresë në **Prishtinë**, i shpallur si fitues i kësaj procedure, ju Njoftojm se i plotëson të gjitha Kushtet sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit: **Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)** dhe është Tenderuesi i përgjegjshëm me çmim më ulët.

Pretendimi 3:

3. *Vlerësimi i tenderit duhet të bëhet brenda 30 ditëve, kurse ky tender është vlerësuar për 34 ditë, dmth 4 ditë jashtë afatit ligjor.*

Përgjigje nga AK 3: Sipas **A01 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, Neni 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.**

41.2 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij **vendimi të AK-së** ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
U.d. Menaxher i Zyres së Prokurimit
Komuna e Rahovecit